



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2022:127066

Datë: 30.05.2024

Numri i dokumentit: 05760157

KPPP.nr.550/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Hasan Kryeziu, në çështjen përmbartimore të kreditorit Kompania Rajonale e Ujësjetllësit “Gjakova” SH.A., me NUI: 811292086, me seli në rr. “UÇK” nr. 7, kundër debitorit “A.Gj.” B.I., me seli në rr. “...” pn., në Gjakovë, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.181/22 të datës 04.05.2022, të Përmbartuesit Privat Gëzim Gjoshi me seli në Gjakovë, jashtë seancës, me datë 30.05.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit “A.Gj.” B.I., ANULOHET urdhri përmbartimor P.nr.181/22 i datës 04.05.2022, i Përmbartuesit Privat Gëzim Gjoshi dhe PËRFUNDOHET në tërësi përmbartimi në këtë çështje përmbartimore.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Kompania Rajonale e Ujësjetllësit “Gjakova” SH.A., ka caktuar urdhrin përmbartimor P.nr.181/22 të datës 04.05.2022, me të cilin ka lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit të besueshëm – Ekstraktit nga librat e kontabilitetit Nr. 039806 të lëshuar nga kreditori, me të cilin është detyruar debitori që në emër të përmbartjes së obligimeve të papaguara nga kartela e konsumatorit të lartcekur, t’ia paguajë kreditorit shumën prej 871.29 €, me kamatë ligjore prej 8%, duke filluar nga dita e propozimit e deri në pagesën definitive, si dhe të gjitha shpenzimet e procedurës përmbartimit, që do të krijohen prej momentit të këtij propozimi, me ndalimin e mjeteve në të holla të cilat debitori i ka të deponuara në llogaritë bankare dhe bartjen e tyre mjeteve në llogarinë e kreditorit, ose borxhi

të realizohet nga regjistrimi, sekuestrimi dhe shitja e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, ka kundërshtuar në tërësi urdhrin përmbarimor, duke theksuar ndër të tjerash se i ka përmbushur të gjitha faturat në emër të konsumimit të ujit të pijshëm. Më tutje ka deklaruar se borxhi i arritur sipas ekstraktit nga librat afarist nga viti 2003 deri në vitin 2022 është konform nenit 378 par. 1 pika 1 të Ligjit Nr. 04/L-077 Për Marrëdhëniet e Detyrimeve (tutje LMD). Ka theksuar se kreditori nuk ka prezantuar asnjë procesverbal për konstatimin e gjendjes faktike në mënyrë që të arsyetojë kërkesën për kompensimin e borxhit. I ka propozuar gjykatës që urdhri për lejimin e përmbarimit të abrogohet në tërësi si i pabazuar.

Kreditore në përgjigjen në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor, ka kundërshtuar në tërësi pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim, duke theksuar ndër të tjerash se propozimi për përmbarim i lejuar nga përmbaruesi privat bazohet në ekstraktin e verifikuar nga librat afarist, përkatësisht në kartelën e debitorit e cila është nënshkruar dhe vulosur nga ana e kreditorit. Në lidhje me pretendimet e kreditorit për ndërprerjen e parashkrimit ka theksuar se debitori është person juridik, andaj parashkrimi duhet llogaritur për tre vite duke u mbështetur në nenin 378 par. 1. Pika 1 e LMD-së ku përcaktohet se bizneset hyjnë në kategorinë e konsumatorëve komercial dhe për më tepër debitori me realizimin e pagesave ka ndërprerë parashkrimin e borxhit duke u bazuar në nenin 368 parag. 1 dhe parag. 2 të LMD-së. Gjykatës i ka propozuar që të refuzohet në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorit.

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike lidhur me këtë çështje përmbarimore me Aktvendimin PPP.nr.1930/2022 të datës 29.09.2023 e ka pranuar në tërësi si të bazuar prapësimin e debitorit dhe ka shfuqizuar Urdhrin Përmbarimor P.nr.181/22 të datës 04.05.2022.

Gjykata Komerciale e Kosovës - Dhomat e Shkallës së Dytë, me Aktvendimin K.DH.SH.II.nr.1609/23 të datës 16.02.2024 ka aprovuar si të themeltë ankesën e kreditorit, e ka prishur Aktvendimin PPP.nr.1930/2022 të datës 29.09.2023 të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike dhe e ka kthyer lëndën në rigjykim dhe rivendosje në Gjykatën Komerciale të Kosovës - Dhomat e Shkallës së Parë.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit dhe kreditorit, vlerësimin të provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe vërejtjeve të dhëna sipas aktvendimit të Gjykatës

Komerciale si dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (tutje LPP) dhe nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 Për Procedurën Përmbartimore, gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe se urdhri përmbartimor duhet të anulohet dhe procedura përmbartimore të përfundohet në tërësi për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se në rastin konkret dokumenti i besueshëm - kartela e konsumatorit Nr. 039806, në bazë të së cilës është lejuar urdhri për përmbartim, nuk i plotëson kushtet e parapara me nenin 29 dhe nenin 37 të LPP-së.

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se “Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”, ndërsa në par.2 të po këtij neni, si dokument i besueshëm sipas ligjit konsiderohen *“ekstraktet e verifikuara nga librat afariste për pagesat e shërbimeve komunale të furnizimit me ujë, energji elektrike dhe bartjen e mbeturinave”*, ndërsa me nenin 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*, kurse me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbartim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*

Në rastin konkret pavarësisht faktit se propozimi për përmbartim është lejuar sipas Ekstraktit nga librat e kontabilitetit në kuadër të Kompania Rajonale e Ujësjellësit “Gjakova” SH.A., gjykata gjen se dokumenti mbi të cilin mbështetet propozimi për përmbartim, e mbi bazën e të cilit përmbartuesi privat ka lejuar përmbartimin, nuk i plotëson kushtet që të konsiderohet dokument i besueshëm për shkak që nuk i përmban tiparet e një ekstrakti nga librat afarist, meqenëse në këtë dokument nuk evidentohet saktësisht periudha kohore për të cilën kërkohet përmbushja e detyrimit.

Nga ekstrakti afarist i bashkëngjitur sipas shifrës Nr. 039806, figuron periudha kohore prej datës 31.08.2015 deri me datën 01.04.2022, ndërsa në përmbajtjen e këtij ekstrakti, nuk janë përfshirë fare shërbimet dhe shuma e borxhit para periudhës prej datës 31.08.2015, me ç’ rast nuk dihet se për cilat shërbime dhe për cilën periudhë kohore është grumbulluar borxhi në fjalë, duke marr parasysh që debitori me datën 31.08.2015, është ngarkuar edhe me një detyrim në emër të “Rregullimit të Borxheve”, në shumën prej 1,100.15 €.

Andaj meqenëse dokumenti në bazë të së cilit është lejuar urdhri përmbartimor, përkatësisht kartela e konsumatorit Nr. 039806, nuk është dokument i besueshëm dhe nuk ka tipare të përmbartueshmërisë, gjykata nuk i shqyrtoi fare pretendimet tjera të debitorit të paraqitura në prapësim dhe kreditorit të paraqitura në përgjigjen në prapësim dhe duke u bazuar në nenin 71 par. 1.1 dhe 73 të LPP-së, nenin 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, si dhe nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.550/24 datë 30.05.2024

Gjyqtari

Hasan Kryeziu

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.